REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 664/22
Datë/Datum. 15.12.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 664/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga Znj. Kimete Gashi - Kryetare, Z.Agon Ramadani– referues, Z. Vedat Poterqoi– Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik "DEZINFEKTIMI AD" SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimet e pastrimit të brendshëm dhe sanitarisë", me numër të prokurimit: Nr. AP: 220-70001-0731-22-11333-2-1-1, iniciuar nga AK– SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN, me datën 15.12.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET pajtimi i palëve për ankesën 664/22 e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 16.11.2022 me numër të protokollit 664/2022, për aktivitetin e prokurimit: "Shërbimet e pastrimit të brendshëm dhe sanitarisë", me numër të prokurimit: Nr. AP: 220-70001-0731-22-11333-2-1-1, iniciuar nga AK– SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN.

II. OBLIGOHET AK – Spitali i përgjithshëm Gjilan që aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e pastrimit të brendshëm dhe sanitarisë", me numër të prokurimit: Nr. AP: 220-70001-0731-22-11333-2-1-1, konform raportit të ekspertit shqyrtues të bëjë ndryshimet e nevojshme për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se palët janë pajtuar, dhe se ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Me 18.10.2022, Autoriteti Kontraktues – SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN ka publikuar Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e pastrimit të brendshëm dhe sanitarisë", me numër të prokurimit: Nr. AP: 220-70001-0731-22-11333-2-1-1.

Me datën 09.11.2022, OE "DEZINFEKTIMI AD" SH.P.K,, ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim. AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim me vendim të datës 10.11.2022.

Me 16.11.2022 OE "DEZINFEKTIMI AD" SH.P.K,, ka parashtruar ankesë me (Nr. protokolli: 664/22), kundër njoftimit për anulim të cituar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e

parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim nenin 113 të LPP ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 01.12.2022, duke i propozuar Panelit Shqyrtues që:
Mendimi i ekspertit shqyrtues

- Ankesa e OE të aprovohet si e bazuar;
- Të anulohet vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

Eksperti shqyrtues i prokurimit, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore, andaj duke u bazuar në kërkesat e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, (Kërkesat dhe Dëshmitë), konsideroj se pretendimi i OE ankues qëndron. Për faktin se, Autoriteti Kontraktues gjatë përgatitjes të këtij aktiviteti të prokurimit, ka përcaktuar kritere të larta dhe nuk ka sqaruar mjaftueshëm KËRKESAT dhe DËSHMITË e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, sepse ky përshkrim në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit krijon paqartësi dhe konfuzitet, rrjedhimisht kufizon konkurrencën e Operatorëve Ekonomik për këtë aktivitet të prokurimit.

Eksperti shqyrtues konsideron se, në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, disa nga kërkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktues, si më poshtë janë kërkesa të larta dhe kufizuese.

Në pajtim me paragrafin 2 të nenit 7 të LPP-së "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik".

Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë. Sipas neni 26.4 të URROPP, Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike. "Të arsyeshme dhe të mjaftueshme".

Ndërsa, Neni 18.4 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, përcakton:

"18.4 Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratës në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë. Veçanërisht, autoriteti kontraktues duhet të ketë parasysh, kur përgatitet dosja e tenderit, që mos të ketë komunikime, diskutime ose negocime në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve. Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike. Në rast se AK organizon vizitë në vend-punishte apo konference para-ofertuese, pjesëmarrja e OE ne vizite në vend-punishte/konference paraofertuese nuk duhet të jete obligative. Vizita në vend-punishte/konference para-ofertuese organizohet për OE dhe është në të mirën e tyre, pra është ndihmese për OE".

Andaj, Eksperti Shqyrtues i prokurimit, duke u bazuar në të gjeturat e lartpërmendura, i propozon AK-së "SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN", që të ulen kriteret në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, dhe gjithashtu duke i sqaruar mjaftueshëm në mënyrë që mos të redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik. Pra, AK në fjalë t'i bëjë përmirësimet e nevojshme në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, nëpërmjet korrigjimit të procedurës përkatësisht Formularit (B54) për procedurën përkatëse dhe të veproj në pajtim me nenin 53.7 të LPP-së.

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, rrjedhimisht i propozon Panelit Shqyrtues të OSHP-së, të obligohet Autoriteti Kontraktues t'i bëjë korrigjimet e nevojshme në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit dhe të veproj në pajtim me nenin 53.7 të LPP-së.

Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët me ç'rast OE ankues pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues, si dhe AK pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Konform nenit 24 par.1 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01./2020 Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritor të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët pohimet, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli.

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues në këtë rast sa i përket kërkesave të vendosura në Dosje të Tenderit që ndërlidhen me pretendimeve ankimore, janë në kundërshtime me nenin 7 të LPP-së, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi. Andaj, AK duhet të bëjë përmirësimet e dosjes së tenderit dhe të shtyjë afatin për ofertim konform nenit 53.7 të LPP-së.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryesuese e Panelit e Shqyrtues

Kimete Gashi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK – SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN;
1x1 OE- DEZINFEKTIMI AD" SH.P.K
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.